

Intervista e Guvernatorit Fehmi Mehmeti për revistën “Monitor”

Si e vlerësoni ecurinë e sektorit bankar në Kosovë gjatë vitit 2021 dhe gjatë pjesës së parë të këtij viti?

Guvernatori Mehmeti: Kosova ka arritur të ndërtojë një sistem financiar të shëndoshë, i cili jo vetëm se u dëshmuoi aftësi të përballojë një ambient shumë të pafavorshëm ekonomik gjatë vitit 2020, por edhe të marrë një rol shumë të rëndësishëm në mbështetjen e ekonomisë për ta përballuar krizën me pasoja sa më të vogla që ishte e mundur. Përkundër rreziqeve të rritura si pasojë e vështirësive ekonomike që kanë trashëguar bizneset nga periudha e pandemisë, sektori bankar ka vazhduar të rritë kreditimin dhe të ruajë shkallën e qëndrueshmërisë. Deri në muajin dhjetor 2021, vlera e kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar ishte mbi 1.8 miliardë euro, përderisa vlera e përgjithshme e kredive aktive në sektorin bankar deri në dhjetor 2021, ishte 3.7 miliardë euro. Gjithsej mjetet e sektorit bankar kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë vitit 2021, duke arritur vlerën prej 5.95 miliardë euro në dhjetor apo një rritje vjetore prej 15.5%. Sektori bankar vazhdon të gëzojë besim të lartë të publiku dhe ky besim është i shprehur edhe në rritjen e vazhdueshme të depozitave. Në dhjetor të vitit të kaluar, vlera e përgjithshme e depozitave ishte rreth 4.90 miliardë euro apo një rritje prej 12.4% në krahasim me vitin 2020. Rritja e depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare në vlerë prej 3.36 miliardë euro, përcjellë nga korporatat jofinanciare me vlerë prej 987.1 milionë euro dhe korporatat tjera financiare në vlerë prej 196.8 milionë euro. Norma mesatare e interesit në kredi në dhjetor 2021, shënoi 5.8 përqind, që është më e ulët krahasuar me normën prej 6.0 përqind e regjistruar në dhjetorin e vitit 2020. Treguesit e shëndetit financiar për sektorin bankar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjitha aspektet. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia e mirë e portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej vetëm 2.4 përqind në dhjetor të vitit 2021, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (2020), norma e kredive joperformuese ishte 3.0%.

Cilat do t'i nënvizonit si zhvillimet më të rëndësishme për bankat që operojnë në Kosovë?

Guvernatori Mehmeti: Sistemi financiar vazhdoi trendin pozitiv të rritjes, mirëpo me një ritëm dukshëm më të ngadalshëm krahasuar me periudhën paraprake. Dinamikat në sistemin financiar gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 u përcaktuan kryesisht nga ngadalësimi i rritjes së depozitave, ndërkohë që kreditimi shënoi rritje të theksuar. Në fund të marsit 2022, asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 8.80 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.1 përqind (12.4 përqind një vit më parë). Në përgjithësi, sektori bankar vazhdon të operojë në një ambient me nivel të ulët të kredive me probleme, likuiditet optimal dhe është mirë i kapitalizuar. Sektori bankar gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të theksuar të kreditimit, mbështetur nga rritja e kërkesës për kredi, financiar përmes depozitave. Rritja e asetëve të sektorit bankar u ngadalësua, pas tri vitesh të rritjes së përshpejtuar, duke reflektuar kryesisht ecurinë e arkëtimit të depozitave. Në mars 2022, gjithsej asetet e sektorit bankar arritën vlerën në 5.82 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.9 përqind. Struktura e asetëve vazhdon të mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku kreditë që kanë peshën më të madhe në kuadër të asetëve (67.5 përqind), pasuar nga ajo e

parasë së gatshme (12.2 përqind), letrave me vlerë (10.5 përqind) dhe mjeteve të mbajtura në bankat tjera komerciale (6.7 përqind) e që kryesisht janë jashtë vendit.

Cili është impakti aktual dhe ai i pritshëm i inflacionit të lartë dhe rritjes së normave të interesit në aktivitetin e sektorit bankar në Kosovë?

Guvernatori Mehmeti: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është duke përcjellë me vëmendje të gjitha zhvillimet ekonomike në Evropë dhe është në koordinim të plotë me Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore të vendeve anëtare të BE-së dhe jo vetëm. Bazuar në Anketën e Kreditimit Bankar, bankat deklaruan që si pasojë e rritjes së çmimeve në vend, gjatë tremujorit të parë, nuk ka pas ndryshim të ofertës kreditore, përderisa kërkesa kreditore kishte rritje në masë të vogël. Megjithatë, sa i përket ofertës kreditore, pothuajse të gjitha bankat nuk përjashtuan mundësinë e përshtatjes së standardeve kreditore dhe kushteve të ofruara për kredi gjatë tremujorëve në vazhdim, nëse vazhdon rritja e çmimeve. Kushtet që mund të ndikohen nga rritja e çmimeve, janë rritja e normës së interesit, si dhe reduktimi i financimit të sektorëve më të ndikuar. Për më tepër, një nga bankat deklaroi se tashmë i kanë ndryshuar politikat e bankës mbi raportin e borxhit ndaj të ardhurave për klientët me të ardhura më të ulëta. Në anën tjetër, kërkesa për kredi gjatë këtij tremujori kishte rritje veçanërisht nga ndërmarrjet për blerjen apo parapagimin e kapitalit punues me qëllim të rezervimit të çmimit. Ngjashëm bankat presin që rritja e kërkesës të vazhdojë, megjithatë ritmi i rritjes së saj përcillet me pasiguri. Gjithashtu, nga përgjigjet e bankave vërehet më shumë pasiguri sa i përket kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, bazuar në ndryshimet në pritje, ku një pjesë e bankave presin kërkesë të shtuar për kredi konsumuese, e njëkohësisht ka banka që presin shtyrje të kërkesës për kredi deri në një periudhë të stabilizimit të çmimeve në treg.

Tashmë shumica e bankave në Kosovë kanë rritur edhe normat e interesit për kredi. Si e shihni ju këtë lëvizje. A ka qenë e domosdoshme të ndodh kjo, dhe çfarë ndikimi do të ketë te qytetarët?

Guvernatori Mehmeti: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nuk ka kompetenca të politikës monetare, andaj normat e interesit përcaktohen nga dinamikat globale në normat e interesit, si dhe nga faktorë tjerë të shumtë në tregun e brendshëm. Për kreditë ekzistuese, shumica e të cilave janë me norma fikse, nuk ndryshon kosto/interesi/kësti; ndërkaq për kreditë me norma variabile të interesit, mund të ndryshojë norma e interesit, varësisht nga ndryshimi i normës referente, kryesisht Euribor-it.

Cilat do të jenë sfidat kryesore për bankat, dhe më gjerësisht për sektorin bankar në Kosovë për pjesën e mbetur të vitit 2022 dhe në vazhdim?

Guvernatori Mehmeti: Si në gjithë botën, ashtu edhe në Kosovë, vitet e fundit kanë qenë mjaft sfiduese dhe të karakterizuara me një pasiguri të lartë, për sistemin financiar dhe për ekonominë e vendit. Si rezultat i kornizës rregullative adekuate si dhe standardeve të larta mbikëqyrëse, situata pandemike e gjeti sistemin bankar në Kosovë me nivele të larta të kapitalit dhe të likuiditetit si dhe kualitet shumë të mirë të mjeteve. Gjithashtu, masat e kujdesshme të ndërmarra

nga BQK-ja në bashkëpunim me institucionet financiare që operojnë në Kosovë janë treguar shumë efektive në ruajtje të stabilitetit financiar dhe minimizimit të pasojave për ekonominë e vendit në përgjithësi. Si rezultat i këtyre masave, sektori bankar arriti ta ruajë shkallën e lartë të qëndrueshmërisë ndaj ndikimit të krizës dhe të përballoj shumë mirë sfidat dhe implikimet e pandemisë, dhe të luajë një rol shumë të rëndësishëm në rimëkëmbjen e ekonomisë përmes kreditimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të masave lehtësuese për kredimarrësit. Lufta në Ukrainë, e cila para së gjithash është një tragjedi njerëzore, në të gjithë botën ka sjell pasoja ekonomike ku tani jemi përballë një ngadalësimi të rritjes ekonomike dhe një rritje të inflacionit, një situatë krejt ndryshe nga ajo pandemike. Sektori bankar tani është në një pozicion shumë të fortë, duke pasur parasysh nivelet e larta të kapitalit, të likuiditetit, kualitetit shumë të mirë të mjeteve, për t'u përballur me këtë goditje. Rreziku kreditor mbetet rreziku kryesor në sektorin bankar, andaj kualiteti i mjeteve në sektorin bankar duhet të menaxhohet me kujdes. Prioritet i yni mbetet që bankat të vazhdojnë ta ruajnë shkallën e lartë të qëndrueshmërisë, andaj rreziku kreditor vazhdon të jetë në fokus të BQK-së edhe në vitin 2022, sidomos duke u përqendruar në vlerësimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut kreditor, adekuatshmërisë së provizioneve për humbjet nga kreditë dhe menaxhimit të kredive me vonesa.

A është i sigurt tregu i bankave në Kosovë dhe sa ofron Kosova siguri për bankat që operojnë aktualisht?

Guvernatori Mehmeti: Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë shumë stabil dhe i sigurt. Kjo reflektohet nëpërmjet treguesve të shëndetit financiar si nivele të larta të kapitalit, likuiditetit, profitabilitet të qëndrueshëm si dhe kualitetit shumë të mirë të mjeteve. Sektori bankar gjithashtu gëzon një besueshmëri të lartë të publikut e cila reflektohet në rritjen e vazhdueshme të depozitave, me një rritje vjetore prej 11.8%. Gjithashtu, korniza rregullative adekuate e vendosur nga BQK, e ngjashme me atë të Bashkimit Evropian si dhe standardeve të Bazelit, mundësojnë një qëndrueshmëri dhe konkurrencë të mirëfilltë në sektorin bankar.

Si e konsideroni ju konkurrencën mes bankave në Kosovë, a ka konkurrencës të pastër?

Guvernatori Mehmeti: BQK vlerëson se ka një konkurrencë të mirëfilltë të bankave në Kosovë. Kjo dëshmohet edhe nga prezenca e gjithsej 11 bankave. Gjithashtu, së shpejti pritet që sektori bankar në Kosovë t'i bashkëngjitet edhe një bankë me kapital vendor, e cila do të kontribuojë tutje në konkurrencën e sektorit bankar.

A pritet që tregut të Kosovës t'i bashkohet edhe ndonjë bankë e re gjatë këtij viti?

Guvernatori Mehmeti: Sektori bankar vazhdon të jetë nxitës, prandaj me Vendimin NR. 26 - 10/2022 të Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, subjektit "Pribank" i është miratuar paraprakisht kërkesa për licencim si bankë. Subjekti "Pribank" obligohet që t'i përmbushë kërkesat e përcaktuara me Nenin 8, paragrafët 5 dhe 6, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe Rregullores për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja, para se të aplikojë për licencë përfundimtare.